

SHOQERIA "POSTA SHQIPTARE " Sh.a

PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Shumat janë të shprehura në Lek)

I. BILANCI FINANCIARE

(Shumat janë të shprehura në Lek)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR POSTA SHQIPTARE sh.a

	Shënime	Viti mbyllur me 31.12.2011	Viti mbyllur me 31.12.2010
AKTIVET			
Aktivitet afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale	1	1,878,251,134	1,815,231,059
Aktivitet afatgjata jomateriale	1	2,508,044	3,067,175
Aktive afatgjata financiare	2	450,000,000	450,000,000
TOTALI 1		2,330,759,177	2,268,298,234
Aktivitet afatshkurtra			
Inventarët	3	121,068,154	232,337,612
Llogari të arkëtueshme tregëtare	4	375,446,078	283,379,499
Llogari të tjera të arkëtueshme	5	324,913,899	446,338,805
Mjete Monetare	6	1,729,455,971	1,426,207,194
TOTALI 2		2,550,884,101	2,388,263,110
TOTALI I AKTIVEVE		4,881,643,279	4,656,561,344
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali			
Kapitali aksionar		1,642,447,000	1,642,447,000
Rezerva nga rivlerësimi		565,261,201	595,367,631
Rezerva të tjera	7	83,666,991	68,787,202
Fondi i Zhvillimit		711,446,770	458,498,560
Fitime/Humbje të pashpërndara		17,870,871	17,870,871
Fitime/Humbje të ushtrimit		208,055,721	297,586,667
TOTALI 3		3,228,748,553	3,080,557,931
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Tatim i shtyrë		-	-
Provizione afatgjata		-	-
Të tjera detyrime afatgjata	8	450,000,000	450,000,000
TOTALI 4		450,000,000	450,000,000
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	9	332,720,539	400,058,566.54
Detyrime tatimore	10	48,417,972	38,973,934
Provizione afatshkurtra		-	-
Detyrime afatshkurtra të tjera të pagu	11	814,790,819	680,033,425
Grante dhe të ardhura të shtyra	12	6,965,395	6,937,527
TOTALI 5		1,202,894,726	1,126,003,453
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		4,881,643,279	4,656,561,384

Drejtori i Përgjithshëm

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lek)

II. PASQYRA TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

	Shënim	Viti mbyllur me 31.12.2011	Viti mbyllur me 31.12.2010
Te ardhura nga shitja	13	1,859,206,177	1,688,630,445
Të ardhura të tjera Operative	14	84,011	1,734,469
Materiale te para dhe te konsumueshme	15	(179,305,844)	(167,007,828)
Shpenzime personeli	16	(966,625,766)	(907,788,453)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	17	(138,061,169)	(107,381,963)
Shpenzime te tjera	18	(409,836,806)	(250,956,508)
Fitimi Operativ		165,460,604	257,230,162
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara(neto)			
Te Ardhura /Shpenzime financiare Neto	19	36,889,222	42,660,560
Transferim i diferencave nga rivleresimi i aktiveve	20	30,106,430	32,093,571
Fitimi para Tatimit		232,456,256	331,984,293
Kreditim i tatimit mbi fitimin			
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(24,400,533)	(34,397,629)
Fitimi neto i Periudhës		208,055,723	297,586,664
Totali i te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse		-	-

Drejtori i Pergjithshem

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lek)

III. PASQYRA E NDRYSHIMIT TE KAPITALI**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO POSTA SHQIPTARE sh.a**

	Kapitali aksioner	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Rezervë rivlerësimi	Fitime të pashpërndara	Fitime të Ushtrimit	Totali
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	1,637,210,000	54,910,241	222,589,777	627,461,202	17,870,871	277,539,208	2,837,581,299
Ndryshimet në kapitalin neto për vitin 2010							
Diferenca nga rivlerësim I tokës, ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve							
Të ardhurat neto të njohura drejtpërsëdrejti në kapitalin neto						265,493,095	265,493,095
Fitimi për periudhën							
Transferim i rezervës nga rivlerësimi në fitimin e periudhës				(32,093,571)		32,093,571	-
Rritja e rezervës së kapitalit		13,876,960	235,908,327			(249,785,287)	-
Dividendët						(27,753,920)	(27,753,920)
Emetim i kapitalit aksioner	5,237,000	456					5,237,456
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	1,642,447,000	68,787,657	458,498,104	595,367,631	17,870,871	297,586,667	3,080,557,930
Ndryshimet në kapitalin neto për vitin 2011							
Diferenca nga rivlerësim I tokës, ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve						-	-
Të ardhurat neto të njohura drejtpërsëdrejti në kapitalin neto							-
Fitimi për periudhën						177,949,293	177,949,293
Transferim i rezervës nga rivlerësimi në fitimin e periudhës				(30,106,430)		30,106,430	-
Rritja e rezervës së kapitalit		14,879,333	252,948,666			(267,827,999)	-
Dividendët						(29,758,667)	(29,758,667)
Kalimi i rezervave në kapital aksioner							-
Emetim i kapitalit aksioner	1,642,447,000	83,666,990	711,446,770	565,261,201	17,870,871	208,055,724	3,228,748,556
Gjendja më 31 Dhjetor 2011							

Administratori

Hartuesi i Pasqyrave Financiar

(Shumat janë të shprehura në Lek)

IV. PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE POSTA SHQIPTARE sh.a

<i>Metoda indirekte</i>	<i>Viti mbyllur me 31.12.2011</i>	<i>Viti mbyllur me 31.12.2010</i>
Veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi/humbja para tatimit	202,349,826	299,890,722
Rregullimet për:		
<i>Amortizimin</i>	138,061,169	107,381,963
<i>Humbjen nga nxjerrja jashtë përdorimit e AAGJ</i>	1,335,801	1,071,304
<i>Provizionet</i>	-	
<i>Humbjet/fitimet e perealizuara nga kembimi</i>	-	
<i>Shpenzimet e interesit</i>	-	
Ndryshimet në kapitalin punues:		
Pakësimi/(Rritja) i inventarëve	111,269,458	(5,089,296.0)
Pakësimi/(Rritja) i llogarive të arkëtueshme	(92,066,579)	(771,119,238)
Pakësimi/(Rritja) i llogarive të tjera të arkëtueshme	121,424,906	-
Rritja/(Pakësimi) e llogarive të pagueshme	(67,338,027)	38,501,537
Rritja/(Pakësimi) e llogarive të tjera të pagueshme	158,295,536	-
Tatim mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(38,466,733)	(34,397,629)
Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit	534,865,357	(363,760,637)
Veprimtaritë investuese		
Blerja e AAGJ	(201,857,913)	(270,135,812)
Arkëtimet nga shitja e AAGJ		
Rivleresim		
Pakësimi/(Rritja) i Investimeve afatgjata financiare		
Fluksi monetar neto i përdorur në veprimtaritë e investimi	(201,857,913)	(270,135,812)
Veprimtaritë financuese		
Arkëtimet nga huamarrjet	-	(918,957)
Pjesmarrje Aktive Afat gjate		
Arkëtimet nga emetimi i kapitalit	-	5,237,456
Dividendë të paguar	(29,758,667)	(27,753,921)
Interesa të paguar		
Fluksi monetar neto i përdorur në veprimtaritë financue	(29,758,667)	(23,435,422)
Rritja/Pakësimi neto i Mjeteve monetare gjatë vitit	303,248,777	(657,331,871)
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit	1,426,207,194	2,083,539,064
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	1,729,455,971	1,426,207,193

Administratori

Hartuesi i Pasqyrave Financiar

1) Informacion i Përgjithshëm

Shoqeria "POSTA SHQIPTARE" sh.a është krijuar si shoqeri anonime me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tirane Nr. 20718 date 03/02/1999. Aksioner i shoqërisë është Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Shoqeria "POSTA SHQIPTARE" sh.a është shoqeri anonime. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit 7638 date 19.11.1992, "Per Shoqëritë Tregtare" dhe në vijim nga ligji Nr.9901 dt 14.04.2008, si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Shoqeria kryen aktivitetin e saj në ambiente që janë në pronësi të saj. Aktivitetet e qëndrueshme prona të saj përbëhen nga toka, ndërtesa, pajisje informatike, mjete transporti etj.

Kapitali i shoqërisë sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Tirane përbëhet nga kontributet e aksionerit të vetëm Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës në shumën 1.642.447.000, leke i ndarë në 1.642.447 aksione me vlerë nominale 1000 leke, të cilat zotërohen 100% nga Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës.

Shoqeria "POSTA SHQIPTARE" sh.a drejtohet nga Këshilli Mbikqyres i cili ka emëruar si Drejtor Zotin Arqile Gorea.

Shenimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare

Politikat kontabel

Politikat kryesore kontabel të adoptuara për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare paraqiten si më poshtë.

1. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Nderkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standarteve Nderkombëtare të Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti Nderkombëtar i Interpretimeve të Raportimit Financiar ("IFRIC") të IASB.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuara nga SNRF për çdo tip të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes përshkruhen më në detaj në politikat kontabel më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa çmuarjeve kritike kontabel. Gjithashtu kjo kërkon që drejtimi të përdoret gjykimi dhe të tij në procesin e përdorimit të politikave kontabel të Shoqërisë. Fushat që përfshijnë një nivel të lartë gjykimi apo kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe çmuarjet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare paraqiten në shënimin 3: *Gjykime, çmuarje dhe supozime të rëndësishme kontabel*.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011.

Të dhënat aktuale në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Lekë.

2. Përmbledhje të Politikave të Rëndësishme Kontabel

a) Monedhat e Huaja

Monedha funksionale dhe prezantimi

Zerë të përfshirë në pasqyrat financiare të Shoqërisë maten duke përdorur monedhën e mjedisit kryesor ekonomik në të cilin entiteti operon (monedha funksionale). Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është monedha e prezantimit të Shoqërisë.

Transaksionet dhe balancat

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të Shoqërisë, transaksionet në monedha të ndryshme krahasuar me monedhën funksionale të Shoqërisë (monedhat e huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në çdo datë të Pasqyrës së pozicionit financiar, aktivitetet dhe detyrimet monetare që janë në monedha të huaja përkthehen me kursin e këmbimit të datës së

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Pasqyres se pozicionit financiar. Diferencat nga kembimi njihen ne fitim ose humbje ne periudhen ne te cilen lindin. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare qe jane njohur me kosto historike ne monedhe te huaj perkthehen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet ne monedha te huaja dhe qe jane paraqitur me vleret e drejte perkthehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten qe eshte percaktuar vlere e drejte.

Monedhat e huaja me te cilat operon Shoqeria jane Euro dhe USD (dollari amerikan). Kursi i kembimit zyrtar i Bankes se Shqiperise (Leku kundrejt njesise se monedhave te huaja) per monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 eshte si me poshte:

	2011	2010
Kurse e kembimit		
Euro/Leke	138.93	138.77
USD/ Leke	107.54	104

b) Njohja e te Ardhurave

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur (ka siguri te arsyeshme) qe perfitimet ekonomike do te hyjne ne Shoqeri dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme, pavaresisht se kur behet pagesa. E ardhura matet me vleren e drejte te perfitimeve te mara per sherbimin e kryer, neto nga tatimi mbi vleren e shtuar dhe zbritje te mundshme te shitjeve.

Te ardhurat nga interesat

Interesat njihen ne propocion me kohen qe reflekton te ardhuren efektive nga aktivi.

c) Tatimet

Tatimi mbi fitimin

Aktivi dhe detyrimi per tatimin mbi fitimin per periudhen aktuale maten me shumet e pritura per t'u marre nga apo per t'u paguar tek organet tatimore. Norma e tatimit dhe ligjet per tatimet e perdorura per llogaritjen e vleres se tatim fitimit, jane ato te nxjerra ose te publikuara ne daten e raportimit ne vend (Shqiperi) ku Shoqeria operon dhe siguron te ardhura te tatueshme.

Drejtimi vlereson ne menyre periodike pozicionet e ndermarra ne formularet e deklarimit te pagesave ne lidhje me situata ne te cilat rregulloret e aplikueshme per tatimet jane subjekt i interpretimeve, si dhe njeh provizione nese eshte e pershtatshme.

Tatimi fitimi i shtyre

Tatimi mbi fitimin i shtyre sigurohet duke perdorur metoden e detyrimit mbi diferencat e perkohshme ndemjet bazes fiskale te aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave te mbartura te tyre per qellime te raportimit financiar ne daten e raportimit. Per vitin 2011 shoqeria nuk ka llogaritur tatim fitimi te shtyre.

3. Aktivet Afagjate Materiale

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, (nëse ka). Ne vitin 2008 ato kane qene objekt rivleresimi.

Toka dhe ndertesa perfshijne pergjithesisht ambjentet e zyrave. E gjithë pasuria e paluajtshme, ndertesat dhe makinerite paraqiten ne kosto, te rivleresuar (sic pershkruhet ne paragrafin e meposhtem) minus amortizimin perkates dhe zhvleresimin, pervec per token, e cila pasqyrohet me koston e rivleresuar minus zhvleresimin. Kosto e aktiveve te ndertuara nga vete Shoqeria perfshijne koston e materialeve, punes direkte, si dhe cdo kosto tjeter qe lidhet me sjelljen e ketyre aktiveve ne gjendje pune dhe koston per cmontimin dhe levizjen e tyre dhe pergatitjen e vendit ne te cilin do te vendosen. Programet kompjuterike te blera qe jane te nevojshme per vendosjen ne funksion te ketyre aktiveve kapitalizohen si pjese e ketyre makinerive.

Aktivitet te cilat jane nxjerre jashte perdorimit jane c'registruar me vleren e tyre neto ne daten e

(Shumat janë të shprehura në Lek)

daljes jashte perdorimit.

Kostot e pjeseve te nderrimit per makinerite dhe pajisjet njihen me vleren e tyre kontabel nese eshte e mundur qe njesia ekonomike te perfitoje te ardhura ekonomike nga kjo pjese dhe keto te ardhura mund te maten ne menyre te besueshme. Kostot e mirembajtjes dhe riparimeve te perditshme te pasurive te paluajtshme, makinerive dhe pajisjeve njihen ne fitim e humbje kur ato ndodhin.

(ii) *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden lineare mbi vleren e mbetur kontabel ne menyre qe, kosto e cdo aktivi deri ne vleren e mbetur, te shperndahet pergjate te gjithe jetes se tij te dobishme si me poshte:

– ndertesat	10 - 30 vjet
– instalime teknike , makineri e pajisje	5 vjet
– mjete transporti	5 vjet
– mobilje dhe orendi	5 vjet
– Pajisje zyra dhe informatike	4 vjet

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) të aktiveve materiale afatgjate janë rishikuar në datën e raportimit.

Toka dhe Ndertimet ne Proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashte perdorimit percaktohen nga krahasimi i perfitimeve nga shitja ose nxjerrja jashte perdorimit me vleren e tyre kontabel. Keto perfshihen ne pasqyren e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.

(iii) *Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuhen atij elementi do të hyjnë në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin

(iv) *Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale*

Shoqeria vlereson ne cdo date raportimi nese ka shenja qe tregojne qe nje aktiv mund te kete pesuar renie ne vlere (zhvleresuar). Nese ka tregues te tille, ose kur kerkohet nje testim vjetor per zhvleresimin e nje aktivi, Shoqeria vlereson shumen e rikuperueshme te aktivitetit.

Shuma e rikuperueshme e nje aktivi eshte me e larta ndermjet vleres se drejte minus kostot e shitjes se aktivitetit apo njesise gjeneruese te parase (NGP) dhe vleres ne perdorim te saj dhe percaktohet per nje aktiv te vecante, pervec kur aktivi nuk gjeneron te hyra monetare qe jane thelbesisht te pavarura nga ato te aktiveve te tjera apo grupeve te aktiveve. Kur vlere e mbartur e nje aktivi ose NGP tejkalon vleren e rikuperueshme, aktivi konsiderohet i zhvleresuar dhe pakosohet deri ne vleren e rikuperueshme te tij.

Ne percaktimin e vleres ne perdorim, flukset monetare te vleresuara skontohen ne vleren aktuale duke perdorur nje norme skontimi para tatimit qe reflekton vleresimin aktual te tregut te vleres ne kohe te parase dhe risqet specifike te aktivitetit. Ne percaktimin e vleres se drejte minus kostot e shitjes, meren ne konsiderate transaksione tregu me te fundit, nese jane te disponueshme. Nese

(Shumat janë të shprehura në Lek)

transaksione të tilla nuk mund të identifikohen, perdoret një model vleresimi i pershtatshëm. Keto llogaritje vertetohen nga perberes të vleresimit, cmimet e aksioneve të kuotuarra për filiale të tregtuara publikisht ose tregues të tjere të vleres së drejte të gatshëm.

Humbjet nga renia e vleres prej operacioneve të vazhdueshme, duke përfshirë zhvleresimin e inventareve njihen në pasqyrën e të ardhurave në kategoritë e shpenzimeve në përputhje me funksionin e aktivitetit të zhvlerësuar, përveç aktiveve afatgjata materiale të rivlerësuarra me pare dhe rivleresimi është kaluar në të ardhurat e tjera renia e vleres njihet gjithashtu në të ardhurat e tjera të mëparshëm.

Për aktivitet duke përjashtuar emrin e mire, vleresimi bëhet çdo datë raportimi nëse ka tregues që humbje të renes së vleres të njohura me pare mund të mos ekzistojnë me ose mund të jenë pakesuar.

Nëse ekzistojnë tregues të tilla, Shoqëria vlereson shumën e rikuperueshme të aktivitetit apo NGP. Një humbje e renes së vleres e njohur me pare rimerret vetëm nëse ka pasur ndryshime në supozimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme të aktivitetit që prej humbjes së renes së vleres të fundit të njohur. Rimarrja kufizohet deri në masën që vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e rikuperueshme, si dhe nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar, neto nga amortizimi nëse humbja nga renia e vleres nuk do të ishte njohur për aktivitetin në vitet e kaluara. Një rimarrje e tilla njihet në pasqyrën e të ardhurave, përveç kur aktiviteti mbahet me kosto të rivlerësuar, në këtë rast rimarrja do të trajtohet si një rritje e rivleresimit.

(d) Aktivitet e marra me qira

Aktivitet e marra me qira janë të klasifikuara si qira financiare kur termat e transferimit të risqeve dhe pronësisë kalojnë të qiramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera janë të klasifikuara si qera operative. Asetet që janë regjistruar si qera financiare regjistrohen si asetë të Shoqërisë me vlerën e drejtë në datën e fillimit të qerasë, ose me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qerasë nëse kjo e fundit është më e vogël.

Pagesat e qerasë regjistrohen si shpenzimeve financiare dhe zvogëlimit të detyrimit të qerasë që të arrijë një normë konstante të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimit.

4. Instrumentat Financiare - Njohja Fillestare dhe Matja në vazhdim

Aktivitet Financiare

Njohja fillestare dhe marja

Aktivitet financiare brenda objektit të SNA 39 klasifikohen si aktive financiare me vlerë të drejte përmes fitimit ose humbjes, huatë dhe të arketueshmet, investime të mbajtura deri në maturim, aktive financiare të disponueshme për shitje, ose si derivative të përcaktuara si instenta mbrojtjes në një mbrojtje efektive siç është e pershtatshme. Shoqëria përcakton klasifikimin e aktiveve të saj financiare në njohjen fillestare.

Të gjitha aktivitet financiare njihen fillimisht me vlerë të drejte plus kostot e transaksionit, përveç rasteve të aktiveve financiare të regjistruara me vlerë të drejte përmes fitimit e humbjes.

Blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë dorezimin e aktivitet gjatë një afati kohor të përcaktuar nga rregullat ose konventat e tregjeve (*rruga e drejte e të marrëdhënieve tregtare*) njihen në datën e transaksionit, p.sh., data kur Shoqëria merr persiper të blejë apo shesë aktivitetin. Aktivitet financiare të Shoqërisë përfshijnë mjetet monetare, llogaritë e arketueshme dhe të tjera të arketueshme, huatë dhe të tjera aktive.

Matja në vazhdim

Matja në vazhdim e aktiveve financiare varet nga klasifikimi i tyre siç përshkruhet më poshtë:

Aktive financiare me vlerë të drejte përmes fitimit ose humbjes

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Aktivitetet financiare me vlerë të drejte përmes fitimit ose humbjes përfshijnë aktive financiare të mbajtura për tregtim të përcaktuara në njohjen fillestare me vlerë të drejte përmes fitimit ose humbjes. Aktivitetet financiare janë klasifikuar si të mbajtura për tregtim nëse janë blerë me qëllim për t'i shitur ose riblerë në një afat të shkurtër kohor. Derivatet, duke përfshirë këtu, derivatet e përfshirë të vecuar, klasifikohen gjithashtu si të mbajtura për tregtim, përveç kur janë përcaktuar si instrumente të mbrojtjes efektive sic përcaktohet nga SNA 39.

Aktivitetet financiare me vlerë të drejte përmes fitimit ose humbjes mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerë të drejte, me ndryshimet neto të njohura si kosto financiare në pasqyrën e të ardhurave.

Aktivitetet financiare të përcaktuara në njohjen fillestare me vlerë të drejte përmes fitimit ose humbjes, përcaktohen në datën e njohjes fillestare dhe vetëm nëse përmbushet kriteri i njohjes sipas SNA 39.

Shoqëria nuk ka përcaktuar ndonjë aktiv financiar me vlerë të drejte përmes fitimit se humbjes.

Huate dhe të arketueshmet

Huate dhe të arketueshmet janë aktive financiare jo-derivative me pagesa të përcaktuara ose fikse dhe që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Pas matjes fillestare, të tilla aktive financiare maten në vazhdim me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e normës së interesit efektive dhe duke zbritur rritjen e vlerës. Kosto e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose shtesa të blerjes dhe tarifave ose kostot që janë pjesë perberëse e normës efektive të interesit. Amortizimi i normës efektive të interesit përfshihet në të ardhurat financiare në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet e njohura nga rritja e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave si kosto financiare për huate dhe në kostot e shitjes ose në shpenzimet e tjera operative për të arketueshmet.

Shoqëria vlerëson nëse aftësia dhe qëllimi për t'i shitur aktivitetet e saj financiare të disponueshme për shitje në një të ardhme të afert është akoma e mundur. Kur Shoqëria e ka të pamundur t'i tregtojë këto aktive financiare për shkak të tregjeve joaktive dhe vendimi i drejtimit ndryshon rrethësisht në të ardhmen e parashikueshme, Shoqëria mund të zgjedhë t'i riklasifikojë këto aktive. Riklasifikimi si hua dhe të arketueshme është i lejueshëm kur aktivitetet financiare përmbushin kriterin e huave dhe të arketueshmeve dhe Shoqëria ka qëllimin dhe aftësinë t'i mbajë këto aktive për një të ardhme të parashikueshme ose deri në maturim. Riklasifikimi në kategorinë e të mbajtura deri në maturim lejohet vetëm kur entiteti ka aftësinë dhe qëllimin t'i npi.ire respektivisht.

Për një aktiv financiar të riklasifikuar nga kategoria e të disponueshme për shitje, vlera e drejte e mbartur në datën e riklasifikimit behet kostoja e saj e amortizimit dhe çdo fitim apo humbje e mëparshme e këtij aktivi që është njohur në kapital amortizohet në fitim ose humbje përgjate jetës së dobishme të mbetur të investimit duke përdorur normën efektive të interesit (NEI). Çdo diferencë ndërmjet kostos së re të amortizuar dhe shumës në maturim amortizohet gjithashtu mbi jeten e dobishme të mbetur të aktivitetit duke përdorur NEI. Nëse aktivi përcaktohet me pas si i rene në vlerë, atëherë vlera e rregjistruar në kapital do riklasifikohet në pasqyrën e të ardhurave.

Ç'rregjistrimi

Një aktiv financiar (ose ku është e mundur pjesë e aktivitetit financiar apo grup aktivesh financiare të ngjashme) ç'rregjistrohet kur:

- *Te drejtat për të siguruar flukse monetare nga aktivi kanë përfunduar*
- *Shoqëria ka transferuar të drejtat e saj për të siguruar flukse monetare nga aktivi.*

Renia në vlerë e aktiveve financiare

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit, nëse ka evidence objektive që një aktiv financiar apo grup aktivesh ka pësuar rritje vlerë. Një aktiv financiar apo një grup aktivesh financiar konsiderohet i zhvlerësuar vetëm nëse ka evidence objektive për zhvlerësimin si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të një aktivi (një "ngjarje humbjeje" e ndodhur) dhe kjo ngjarje humbjeje ka pasur ndikim mbi flukset monetare të ardhshme të vlerësuar të aktivitetit financiar apo grupit të aktiveve financiare dhe që mund të matet në mënyrë të besueshme. Evidence e zhvlerësimit mund të përfshijë tregues që debitorët apo grup debitorësh

(Shumat janë të shprehura në Lek)

mund të jenë duke përjetuar probleme të mëdha financiare, mospagesa në kohë të principalit apo interesit, probabiliteti që ata të kalojnë në falimentim ose një riorganizim tjetër financiar dhe kur

te dhenat e vëzhgueshme tregojnë se ka një rënie të matshme të flukseve monetare të ardhshme të parashikuara, të tilla si ndryshime në fusha dhe kushtet ekonomike që janë në korrelacion me vonesat.

Aktivitet financiar me kosto të amortizuar

Per aktivitet financiar të mbajtura me kosto të amortizuar, Shoqëria fillimisht vlerëson nëse ka evidence objektive për zhvlerësimin për aktivitet financiar individualisht dhe që janë në mënyrë individuale të rëndësishme, ose në kolektiv për aktive financiare që nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse Shoqëria përcakton që nuk ka evidence objektive për zhvlerësimin për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, pavarësisht nëse është i rëndësishëm apo jo, e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika rreziku krediti të ngjashëm dhe i vlerëson në mënyrë kolektive për zhvlerësim. Aktivitet që vlerëson individualisht për zhvlerësim dhe për të cilat ka ose do të ketë një humbje nga zhvlerësimi, nuk do të përfshihen në një vlerësim kolektiv zhvlerësimi.

Investime financiare të disponueshme për shitje

Per aktivitet financiar të disponueshme për shitje, shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka evidence objektive që një investim apo grup investimi të jetë zhvlerësuar.

Letrat me vlerë të kapitalit nuk rimerren nepermjet pasqyres së të ardhurave; rritjet në vlerën e drejtë pas zhvlerësimit njihen drejtpërdrejtë në të ardhurat gjithëpërfshirëse.

Në rastin e instrumentave të borxhit të klasifikuara si të disponueshme për shitje, rënia e vlerës vlerësohet bazuar në të njëjtin kriter si aktivitet financiar me kosto të amortizuar. Megjithatë shuma e rregjistruar për zhvlerësimin është humbja e akumuluar e matur si diferencë ndërmjet koston të amortizuar dhe vlerës së drejtë aktuale pakesuar me C+ së vlerës të atij investimi të njohur me parë në pasqyrën e të ardhurave.

Të ardhurat nga interesi vazhdojnë të përlogariten mbi vlerën e reduktuar të mbartuar të aktivitet, duke përdorur normën e interesit të përdorur për të skontuar flukset monetare të ardhshme me qëllim matjen e humbjes nga rënia e vlerës. Të ardhurat nga interesi rregjistrohen si të ardhura financiare.

Nëse në një vit të mëvonshëm, vlera e drejtë e një instrumenti borxhi rritet dhe kjo rritje mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje të ndodhur pas njohjes në pasqyrën e të ardhurave të humbjes nga rënia e vlerës, humbja nga rënia e vlerës rimerret nepermjet pasqyres së të ardhurave.

Detyrimet financiare

Njohja fillestare dhe matja

Detyrimet financiare që përfshihen në qëllimin e SNK 39 klasifikohen si detyrime financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, hua dhe kredi, ose si derivative të përcaktuara si instrumenta mbrojtës në një mbrojtje efektive, si është me e pershtatshme. Shoqëria përcakton në njohjen fillestare klasifikimin e detyrimeve financiare të saj.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë, plus kostot direkte të transaksionit në rastin e huave dhe kredive.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime.

Matja e mëvonshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre sic përshkruhet me poshte:

Detyrime financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes përfshijnë detyrimet financiare të mbajtura për tregëtim dhe detyrimet financiare të përcaktuara që në njohjen fillestare si me

(Shumat janë të shprehura në Lek)

vlere te drejte permes fitimit ose humbjes.

Detyrimet financiare klasifikohen si te mbajtura per tregetim nese jane blere me qellimin per ti shitur ne nje te ardhme te afert. Shoqeria nuk ka percaktuar ndonje detyrim financiar si te mbajtur

per shitje. Fitimet ose humbjet ne detyrimet e mbajtura per tregetim njihen ne pasqyren e te ardhurave.

Detyrimet financiare te percaktuara ne njohjen fillestare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, percaktohen qe ne daten e njohjes fillestare dhe vetem nese permbushet kriteri i SNK 39.

Shoqeria nuk ka percaktuar ndonje detyrim financiar si me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes.

Huate dhe kredite

Pas njohjes fillestare, huate dhe kredite qe mbartin interes maten ne vazhdim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e normes efektive te interesit (NEI). Fitimet dhe humbjet njihen ne pasqyren e te ardhurave kur detyrimet crregjistrohen si dhe nepermjet procesit te amortizimit NEI.

Kosto e amortizuar llogaritet duke mare parasysh cdo zbritje apo mbivlere ne blerje dhe tarifat apo kostot qe jane pjese perberese e NEI. Amortizimi NEI perfshihet ne shpenzimet financiare ne pasqyren e te ardhurave.

Çrregjistrimi

Nje detyrim financiar crregjistrohet kur angazhimi i detyrimi shkarkohet, anulohet apo skadon. Kur nje detyrim financiar ekzistues zevendesohet me nje tjetër huadhenes me terma totalisht te ndryshme, ose kur termat e nje detyrimi ekzistues ndryshohen thelbeisht, nje kembim i tille apo modifikim trajtohet si çrregjistrim i detyrimit orgjinal dhe njohja e nje detyrimi te ri.

Diferenca ne vleren e mbartur respektive njihet ne pas pasqyren e te ardhurave

Kompensimi i instrumentave financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlere neto raportohet ne pasqyren e pozicionit financiar nese, dhe vetem nese:

- Ka nje te drejte ligjore te detyrueshme per te kompensuar vlerat e njohura dhe,
- Ka nje qellim per te zgjidhur ceshtje mbi bazen neto, ose te realizohet aktivi dhe te shlyhet detyrimi ne te njejten kohe

Vlera e drejte e instrumentave financiare

Per instrumentat financiare qe nuk tregtohen ne tregje aktive, vlere e drejte percaktohet duke perdorur teknika vleresimi te pershtatshme.

Teknika te tilla mund te perfshijne:

- Perdorimin e transakcioneve aktuale me vlerat e tregut
- Referimin e vleres se drejte aktuale te nje instrumenti qe eshte thelbesisht i njejte
- Nje analize te flukseve monetare te skontuara ose modele te tjera vleresimi.

5. Inventaret

Inventaret jane vleresuar me me te voglen ndermjet koston dhe vleres neto te realizueshme. Kosto e inventareve bazohet ne metoden e koston mesatare te ponderuar, dhe perfshin shpenzime te hasura ne blerjen e inventareve, prodhimin apo kostot e transformimit dhe shpenzime te tjera te hasura deri ne sjelljen e tyre ne kushtet dhe vendin ekzistues. Ne rastin e inventareve te prodhuar dhe punimit ne proces, kosto perfshin edhe nje pjese te pershtatshme te shpenzimeve te pergjithshme te prodhimit bazuar ne kapacitetin normal operativ. Vlere neto e realizueshme eshte cmimi i shitjes i pritur ne kushtet normale te biznesit, minus kostot e pritura te perfundimit dhe shpenzimet e nevojshme te vleresuara per te kryer shitjen.

(Shumat janë të shprehura në Lek)

6. Mjetet Monetare

Mjetet monetare ne pasqyren e pozicionit financiar perfshijne mjetet monetare ne banke dhe ne arke dhe me nje maturitet prej me shume se 3 muajsh.

Per qellime te pasqyres se flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre konsistojne ne mjete monetare dhe sic percaktohet me siper.

7. Perfitime e Punonjesve

▪ Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore

